



### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_95\_06\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Tafil Naziri pronar i “Kompanisë së Sigurimeve” nga Drenasi (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90041593), për arsyet e paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE të datës 08.05.2008 ka apeluar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KEK të datës 06.05.2008 lidhur me kontestimin e faturës së muajit 12/2007.

- Në muajin 12/2007 konsumatorit i ka arritur nga ana e KEK-ut fatura prej 343.42 € e shprehur financiarisht ose 4680 kWh si shpenzim mujor.

**Provë:** Transaksionet e konsumatorit

- Me datë 26.01.2008 Divizioni i Rrjetit në KEK ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik me anë të vërtetimit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 001638 me anë të së cilës është hequr njehsori digjital nr. 20042 dhe është vendosur njehsori nr. 4939877.

**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 001638

- Me datë 31.03.2008 Qendra e Kalibrimit në KEK ka bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik me anë të Protokollit mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr 1694 në të cilin ceket se njehsori elektrik është në kufij të lejuar të matjes.

**Provë:** Protokoli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik të KEK-ut nr. 1694



- Me datë 14.04.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit 12/2007.

**Provë:** Dëftesa dhe ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 06.05.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në protokollin e qendrës së kalibrimit.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 06.05.008

- Me datë 08.05.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.

- DMK në ZRRE pas rishikimit të dëshmimeve dhe analizave të bëra ka vendosur që të kthejë KEK-ut lëndën e konsumatorit për rishqyrtim në arsyetimin se ka elemente që duhet edhe njëherë të analizohen dhe shqyrtohen.

- Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe të furnizuesit publik, nuk ka gjet arsye teknike për ta pranuar ankesën e konsumatorit.

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatori, ka vërejtur se:

- ✓ Në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit në hapësirën e njehsorit digjital të vjetër shihet se është marrë gjendja e njehsorit: tarifa e lartë dhe e ultë, ndërsa në vërejtjen e tyre kanë shënuar se njehsori nuk ka pas orë tarifore, mirëpo është bërë shpenzim në të dy tarifat.

**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 001636

- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit prej momentit të vendosjes (01/2006) së njehsorit digjital e deri në muajin 11/2007 është 188 kWh, ndërsa shuma e përgjithshme e shpenzimit prej 01/2006 deri 11/2007 është 4323 kWh.

**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive

- ✓ Në faturën e muajit 12/2007 shihet se tarifa e dytë përnjëherë ka regjistruar 4332 kWh, ndërsa tërë shpenzimi i energjisë elektrike prej momentit të vendosjes së njehsorit elektrik e deri më 12/2007 ka regjistruar 4323 kWh.

- ✓ **Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive

- ✓ Sipas rrjedhjes së energjisë aktive shihet se tarifa e ulët e njehsorit nuk ka funksionuar asnjëherë, pra që prej fillimit ka regjistruar 0 kWh.

**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive

- ✓ Duke analizuar rrjedhjen e energjisë aktive të konsumatorit shihet se tarifa e ulët e konsumatorit përafërsisht është barazuar me tarifën e lartë dhe ka ardhur deri te regjistrimi i sasisë enorme të kilovatëve.



- ✓ Pika matëse e konsumatorit është lexuar rregullisht.

**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive

DMK duke u bazuar në analizat e bëra, i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta pranojë ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së. Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin nga fatura e muajit 12/2007.
2. Për muajin e 12/2007 ta ngarkojë konsumatorin me një mesatare të shpenzimit të energjisë gjatë muajve të dimrit.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Nysret Avdiu, Anëtar